



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr.129, Datë 20/05/2018

Mbështetur në informacionin e përcjellë nga ana e Zyrës së Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA), nëpërmjet shkresës nr. 0379 Prot, datë 19.02.2018, mbi situatën e rënduar higjeno-sanitare të fëmijëve dhe familjeve rome, në zonën e “Rrugës së Qelqit”, në kufinj të Kombinat-Kashar, Tiranë, për shkak të mungesës së ujit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në referencë të gërmës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, filloi procedurat administrative për shqyrtimin e çështjes ex-officio.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban shkresa nr. 0379 Prot, datë 19.02.2018, e Zyrës së Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA), drejtuar Z. A. S., Drejtor i Agjensisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe për dijeni Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi rezultonte se, në zonën e “Rrugës së Qelqit”, në kufinj të Kombinat-Kashar, Tiranë, ishte krijuar një situatë e rënduar higjeno-sanitare e familjeve rome, për shkak të mungesës së furnizimit me ujë.

Në shkresën e sipërpërmendur, Zyra së Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA) kërkon nga ana e Agjensisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve marrjen e masave të menjëherëshme për të furnizuar zonën me ujë, pasi banorët e asaj zonë vuanin prej vitesh nga kjo gjendje.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Në referencë të gërmës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet Urdhërit nr. 44, datë 23.02.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi menjëherë procedurat administrative për shqyrtimin e çështjes ex-officio.
2. Nëpërmjet shkresës nr.285/1, datë 26.02.2018, Komisioneri iu drejtua Zyrës së Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA), ku kërkoi informacion mbi ankesat e depozituara pranë kësaj shoqate, nga banorët e zonës së Rrugës së Qelqit, informacion mbi gjendjen e tyre aktuale, si dhe nëse kishte patur reagim zyrtar nga ana e institucioneve përgjegjëse mbi çështjen në fjalë.
 - Për sa më sipër, Zyra e Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA) nuk i ktheu përgjigje shkresës nr. 285/1, datë 26.02.2018, së Komisionerit.
3. Njëkohësisht, nëpërmjet shkresës nr. 296 Prot., datë 26.02.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Agjensisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe për dijeni Njësisë Administrative Kashar¹ dhe CRCA-së, ku kreu njoftimin mbi fillimin e shqyrtimit të çështjes ex-officio, si dhe kërkoi informacion nga institucioni përgjegjës mbi çështjen në fjalë.
 - Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dërgoi shkresën nr. 580/1, datë 21.03.2018, nëpërmjet së cilës Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bëhet me dije se ky institucion nuk disponon asnjë informacion, lidhur me çështjen, për të cilën po hetohet ex-officio, pasi Agjensia nuk merret me mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Në shkresën e sipërpërmendur, Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve sugjeron që Komisioneri t’i drejtohet ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizimeve, Tiranë, për të administruar informacionin e kërkuar. Bashkëlidhur shkresës nr. 580/1, datë 21.03.2018, Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve ka përcjellë edhe

¹ Shkresa nr. 296 Prot., datë 26.02.2018,e Komisionerit iu ridërgua Njësisë Administrative Kashar nëpërmjet shkresës nr. 296/1, datë 05.03.2018, pasi u kthye nga Shërbimi Postar.

kopje të shkresës së saj nr. 547/1, datë 26.02.2018, nëpërmjet së cilës i është dërguar e njëjta përgjigje edhe CRCA-së, mbi çështjen në fjalë.

- Njësia Administrative Kashar nuk reagoi ndaj shkresës së Komisionerit dhe nuk dërgoi asnjë informacion mbi çështjen në fjalë.
- 4. Nëpërmjet shkresës nr. 434, datë 28.03.2018, iu dërgua njoftim dhe kërkesë për informacion, Z. Redi Molla, Administrator i Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe CRCA-së.
- Ujësjetllës Kanalizime sh.a. nuk dërgoi asnjë informacion pranë Komisionerit.
- 5. Në vijim të shqyrtimit të çështjes ex-officio, si dhe në mungesë të informacionit të nevojshëm të dërguar nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a., mbështetur në Urdhërin nr. 74, datë 12.04.2018, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 16.04.2018, u krye inspektim pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a.

Gjatë inspektimit të kryer pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. u administrua informacion i pjesshëm, lidhur me çështjet që përbënin objekt inspektimi, pasi strukturat përgjegjëse të shoqërisë nuk e kishin përgatitur ende informacionin e kërkuar nga Komisioneri. Në këto kushte u ra dakord që informacioni i kërkuar të dërgohej në adresë të Komisionerit, në ditët në vijim.

- Me shkresën nr. K-1819/1, datë 26.04.2018, Ujësjetllës Kanalizime sh.a. e bën me dije Komisionerin, se pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme, në të cilat ka qenë prezent edhe një përfaqësues i CRCA-së, është konstatuar se në zonë ka një rrjet furnizimi me ujë të pijshëm, në të cilin banorët mund të kenë akses vetëm përmes kontratave të rregullta me UKT. Zona është në proces azhornimi, si dhe Njësia Zonale nr. 5 e UKT-së po kujdeset që çdo linjë furnizimi të operojë pa problematika.

Për sa i përket çështjes, që lidhet me 18 familjet rome, pas verifikimeve të kryera u konstatua se këta banorë nuk kanë lidhur kontrata ligjore me shoqërinë UKT sh.a. për shërbimin e furnizimit me ujë në përputhje me pikat 2.9.2 të Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009.

UKT sh.a. informon se ka marrë masat paraprake për verifikimin e situatës dhe problematikave për çdo familje dhe nga ana e përfaqësuesit të CRCA u mor përsipër asistencë e banorëve për mbledhjen dhe depozitimin e dokumentacionit përkatës pranë pikave të UKT sh.a., për vijimin e procedurave të lidhjes së kontratave, në mënyrë që lidhja e tyre me rrjetin e ujësjetllës të rregullohet konform bazës ligjore.

Ndërkohë që, në planet afatshkurtëra, UKT po vlerëson mundësinë teknike të përgatitjes së projektit teknik që do të mundësojë formalizimin dhe shpërndarjen e linjave të reja të furnizimit për çdo kontratë që do të lidhet.

6. Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 606, datë 04.05.2018, Zyrës së Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA), ku kërkoi informacion më të zgjeruar mbi asistencën e dhënë ndaj banorëve në zonën e “Rrugës së Qelqit”, në kufinj të Kombinat-Kashar, Tiranë dhe progresin e deritanishëm.

- Në përgjigje të shkresës nr. 606, datë 04.05.2018, së Komisionerit, Zyra e Mbrojtjes Ligjore për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri (CRCA) dërgoi shkresën nr. 0391, datë 16.05.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin mbi hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, falë raportimit dhe ngritjes së shqetësimit nga ana e CRCA-së pranë Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR) dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik (DSHP), në Njësinë Administrative Nr. 6 (Kombinat) u bë i mundur vaksinimi i 50 fëmijëve të komunitetit rom për t’u mbrojtur nga fruthi, pasi si pasojë e mungesës së ujit të pijshëm në 18 familjet e komunitetit rom kishte rënë epidemia e fruthit, si dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse.

Në datën 16 prill 2018, 18 familjet e komunitetit rom në Njësinë Administrative Nr. 6, Kombinat u furnizuan me ujë të pijshëm dhe vijoje të kenë ujë të pijshëm pas 1 viti e gjysëm mungese. Aktualisht, Bashkia e Tiranës, si dhe Njësia Administrative Nr. 6, në Kombinat janë duke koordinuar punën për të bërë të mundur, lidhjen e kontratave të ujit të pijshëm me 18 familjet e komunitetit rom.

- Nëpërmjet e-mailit, të datës 24.05.2018, CRCA e bën me dije Komisionerin, se çështja e banorëve të rrugës së Qelqit konsiderohet e zgjidhur, pasi banorët tashmë furnizohen me ujë të pijshëm dhe janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, për lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë të pijshëm.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të çështjes ex-officio rezulton se mosfurnizimi me ujë i 18 familjeve romë ka ardhur si rezultat i moslidhjes së kontratave të furnizimit me ujë me Ujësjetellës Kanalizime sh.a.

Në pikën 2.3.2, të Vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a.” parashikohet shprehimisht se: “Për të përfituar të drejtën e pikës së lidhjes për furnizimin me ujë të pijshëm për një objekt, konsumatori kërkues duhet të paraqesë tek Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) në UK___sh.a.:

- Kërkesë me shkrim në të cilën është përcaktuar sasia e ujit që kërkon (m³ në muaj ose l/sek);
- Leja e ndërtimit,
- Akti i pronësisë së objektit,
- Planimetrinë e vendosjes së objektit
- Projekti hidraulik i sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë, i cili realizohet nga persona ose subjekte të licensuara”.

Në pikën 2.9.2, të Vendimit të sipërpërmendur parashikohet: “Furnizimi me ujë të pijshëm nga UK___ sh.a. për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë shtetërorë ose private, bëhet në bazë të kontratave të shitjes (furnizimit me ujë) që lidhen ndërmjet tyre.”

Sikurse rezulton nga sa më sipër, furnizimi me ujë për konsumatorët familjarë bëhet pas paraqitjes së një kërkesë me shkrim dhe dokumentacionit të sipërcituar pranë ZMK-ve dhe në vijim, nëpërmjet lidhjes së një kontratë furnizimi me UKT sh.a.

Familjet romë të Zonës së Qelqit, të cilave iu ishte ndërprerë furnizimi me ujë ka ardhur si pasojë e mos ndjekjes së procedurave përkatëse, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit përkatës pranë ZMK-ve dhe lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1², të Ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se në kushtet, kur ligjvënësi ka hartuar akte nënligjore, zbatimi i të cilave është i detyrueshëm për të gjithë, 18 familjet, që i përkasin komunitetit rom, banues në zonën e Rrugës së Qelqit, nuk i janë ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga UKT sh.a.

² Neni 7, pika 1, e ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

II. Shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes ex-officio, shkaqet e dyshuara të diskriminimit, kanë qenë “raca” dhe “gjendja ekonomike”, e familjeve rome, banuese në zonën e rrugës së Qelqit, të cilat nuk furnizoheshin me ujë të pijshëm.

“Raca” dhe “Gjendja Ekonomike” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në pikën 1, të nenit 7 të ligjit të sipërpërmendur parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në mungesë të një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të këtyre familjeve nga ana e UKT sh.a., nuk mund të ketë diskriminim për asnjë nga shkaqet e sipërpërmendura. Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se në Vendimin nr.18, datë 12.01.2018, e Këshillit të Ministrave “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë” janë përcaktuar kategoritë në nevojë që përfitojnë nga subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit, ku bëjnë pjesë edhe familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, si dhe kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, ose që përfitojnë pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Familjet në kategoritë e sipërpërmendura, përfitojnë gjithashtu edhe matësit falas.

Për sa më sipër, përfaqësuesit e CRCA³ e kanë bërë me dije Komisionerit, se 18 familjet që banojnë në zonën e Rrugës së Qelqit, e përfitonin falas lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe matësit respektivë.

Mbështetur në informacionin e dërguar nga CRCA, çështja rezulton e zgjidhur pasi aktualisht 18 familjet rome që banojnë në zonën e Rrugës së Qelqit, furnizohen me ujë të pijshëm dhe janë në proces për plotësim dokumentacioni për lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë me UKT sh.a.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma c), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe pikave 2.3.2 dhe 2.9.2, të Vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a.”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”, të 18 familjeve rome, që banojnë në zonën e “Rrugës së Qelqit”, në kufinj të Kombinat-Kashar, Tiranë, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak: raca, gjendja ekonomike
Fusha: të mira dhe shërbime)

³ Informacioni është marrë në një bisedë telefonike me përfaqësues të CRCA-së, në datën 24.04.2018.

